

D E K R E T
Nr.7447, datë 5.1.1991

**PËR KRIJIMIN E BANKAVE ME PJESËMARRJEN E KAPITALIT TË HUAJ DHE
PËR ÇELJEN E DEGËVE OSE TË ZYRAVE TË PËRFAQËSIMIT TË BANKAVE TË
HUAJA NË REPUBLIKËN POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të ministrave;

**PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË**

V E N D O S I :

Neni 1

Me propozimin e Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, Këshilli i Ministrave autorizon krijimin, brenda dhe jashtë shtetit, të bankave me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj.

Neni 2

Banka me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj (më poshtë e quajtur "banka") synon shtimin e të ardhurave në valut të vendit, rritjen e eksportit dhe pakësimin e importit, modernizimin e objekteve ekzistuese ose ngritjen e objekteve të reja ekonomikisht të leverdishme e me teknologji të përparuar, si dhe futjen e metodave bashkohore për organizimin e drejtimin e prodhimit, të shërbimeve etj.

Neni 3

Objekti dhe veprimtaria e e bankës përcaktohet në kontratën e në statutin e saj.

Neni 4

Kërkesa e një personi juridik shqiptar për të zhvilluar veprimtari bankare bashkërisht me një person juridik a fizik të huaj, brenda ose jashtë Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë i drejtohet Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë dhe duhet të përmbajné:

- a) subjektet e interesuara;
 - b) emrin e bankës, qendrën e saj dhe të dhënat lidhur me personat e huaj;
 - c) qëllimin dhe përshkrimin e veprimtarisë së bankës;
 - ç) pjesën e kapitalit që do të vëri secili pjesëtar.
- Kërkesa shoqërohet edhe me këto dokumente:
- a) projektkontrata dhe projektstatuti;
 - b) kopje të vërtetuara të bilancit të pjesëtarit të huaj për tre vjetët e fundit, nëse do të kërkohet nga Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë;
 - c) dokumenti i lëshuar nga autoritetet e vendit të pjesëtarit të huaj, ku do të vërtëtohet se ai i ka përmbushur kërkesat e mundshme të legjislacionit të vet për krijimin e bankës;
 - ç) kur personi juridik i huaj është një bankë, leja e organit drejtues të saj për ta krijuar bankën;

d) përshkrimi i veprimtarive që do të kryejë kjo bankë, së bashku me raportin teknik, ku të përfshihen fakte e shifra të bazuara në planin e operacioneve dhe veprimtarinë e pritshme të bankës, vëllimi i punës, fitimi e shpenzimet.

Neni 5

Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, brenda 60 ditëve nga marrja e kërkesës dhe e dokumenteve të përcaktuara në nenin 4, jep mendimin e saj, të cilin ia njofton palës kërkuuese. Kur kërkesa vlerësohet e pranueshme, Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë i përcjell Këshillit të Ministrave propozimin për krijimin e bankës, kërkesën për lëshimin e autorizimit, si dhe gjithë dokumentacioni përkatës.

Neni 6

Pas dhënies së autorizimit prej Këshillit të Ministrave, banka do të ketë qendrën në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, duhet ta nisë veprimtarinë e saj brenda datës ose afatit të përcaktuar në autorizim, përndryshe ky i fundit quhet i shfuqizuar.

Neni 7

Bankat e huaja mund të kryejnë veprimtari bankare në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë nëpërmjet degëve ose zyrave të tyre të përfaqsimi, çelja e të cilave bëhet me autorizim të drejtorit të Përgjithshëm të Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë.

Kërkesës për të çelur degë ose zyra përfaqësimi në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë duhet t'i bashkëngjitet dokumentacioni përkatës, i cili përcaktohet nga Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë.

Neni 8

Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë ushtron kontroll mbi veprimtarinë e bankës dhe të degëve ose zyrave të përfaqsimi të bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë sipas rregullave të caktuara prej saj.

Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë ka të drejtë të caktojë një kuotë jo më të lartë se 10 për qind të kapitalit të bankës që vepron në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për ta depozituar pranë saj si rezervë të detyrueshme pa interesa.

Banka që vepron në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë është e detyruar që t'i paraqesë Bankë së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, jo më vonë se 31 marsi i vitit pasardhës, raportin vjetor dhe bilancin e miratuar nga organi kompetent i bankës për vitin financiar të mëparshëm.

Neni 9

Fitimet e realizuara nga banka dhe nga degët ose zyrat e përfaqsimi të bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, taksohen. Masa e taksës caktohet nga Ministria e Financave.

Pas miratimit të raportit vjetor dhe të bilancit të bankës nga Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë, pjesa e fitimit neto që i përket pjesëtarit të huaj, mund të transferohet lirisht jashtë shtetit pa asnjë kufizim.

Neni 10

Kur Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë vëren parregullsi në veprimtarinë e bankës deh të degëve ose zyrave të përfaqësimit që veprojnë në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, ua bën të ditur atyre menjëherë, duke u dhënë edhe afat për ndreqjen e tyre.

Kur brenda afatit të dhënë nuk merrren masat e nevojshme për ndreqjen e këtyre parregullsive, ose kur këto janë për çështje shumë të rëndësishme, Banka e Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë i propozon Këshillit të Ministrave të shfuqizojnë autorizimin për krijimin e bankës ose shfuqizon autorizimin e lëshuar prej saj.

Neni 11

Bankat dhe degët ose zyrat e përfaqësimit të bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i nënshtrohen legjislacionit shqiptar.

Kur banka e ka qendrën e saj jashtë territorit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, zbulohet legjislacioni i vendit ku ajo e ka qendrën.

Neni 12

Marrëdhëniet e punës në bankë dhe në degët ose zyrat e përfaqësimit të bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështje që nuk rregullohen në kontratën e punës zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar të punës.

Mosmarrëveshjet e punonjësve me bankën dhe me degët ose zyrat e përfaqësimit të bankave të huaja që veprojnë në territorin e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, zgjidhen nga gjykata shqiptare. Kur pala ankuese është një punonjës i huaj, mosmarrëveshja zgjidhet nga organi që përcaktohet në kontratën e punës.

Neni 13

Banka merr fund:

- a) në rastin e parashikuar nga neni 10, paragrafi i dytë i këtij dekreti;
- b) kur është arritur qëllimi për të cilën është krijuar posaçërisht kjo bankë ose kur ai nuk mund të arrihet;
- c) kur është plotësuar koha për të cilën është krijuar kjo bankë, ashtu siç është përcaktuar në kontratë dhe në statut;
- ç) kur pjesëtarët merren vesh për t'i dhënë fund kësaj banke;
- d) kur merr fund njëri nga pjesëtarët.

Në rastet e përmendura në shkronjat b, c, ç dhe d vendimi merret nga organi më i lartë i bankës dhe i njoftohet menjëherë Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë.

Neni 14

Kur banka merr fund pasuria e përbashkët ndahet ndërmjet pjesëtarëve në përpjestim me pjesët e secilit, pasi të jenë paguar të gjitha detyrimet ndaj të tretëve e detyrimet ndaj shtetit.

Sendet e vëna nga pjesëtarët për përdorim të përbashkët, i kthehen secilit pjesëtar që i ka vënë.

Neni 15

Kur ka mosmarrëveshje në ndarjen e pasurisë, kompetente për t'i zgjidhur ato është gjykata e vendit ku ndodhet qendra e bankës.

Neni 16

Ky dekret hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në "Gazetën Zyrtare".

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
Sihat Tozaj

KRYETARI
Ramiz Alia